

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN –Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të pandehurit, S. N. , për shkak të veprës penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së , sipas aktakuzës , të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 30.11.2016 ndërsa më dt. 05.12.2016 hartoi këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S. N.**, nga babai H. dhe nëna H. e lindur A. , i lindur më dt. në fshatin D. Komuna e P., me vendbanim në Gjilan në lagjen “ A..” rruga “a të kryer shkollën e mesme i pa punësuar, i martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës. Më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e, më datë, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij, në Gj., i pandehuri, si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar shërbime komunale, në atë mënyrë që në vende – ngjarje punëtorët e autorizuar të...., kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr., është i bllobuar, ndërsa gjatë kontrollimit të mëtutjeshëm është konstatuar se konsumatori ka larguar dy urat e tensionit te faza “R” dhe “S”, ashtu që i pandehuri pa autorizim të furnizuesit të autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar me çka është pamundësuar regjistrimi i sakët, i shpenzimeve të energjisë elektrike në këtë mënyrë të dëmtuarësDistrikti në G... i ka shkakuar dëm material në shumë prej€.

- me çka ka kryer veprën penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së .

Andaj gjykata, duke u bazuar në dispozitën e sipër theksuar ligjore si dhe neneve: 4, 41, 49 50,51, 52, 73, 74,75,76 të KPRK si dhe nenit dhe 365 të KPP-ës, të pandehurit Skender Nuredini i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit, **S. N.**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i pandehuri brenda (1) një viti , nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

Detyrohet i pandehuri që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara -, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

PTHDP në Gjilan ka paraqitur aktakuzën kundër të pandehurit S.N. , për shkak të veprës penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve komunale nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën ka prezantuar prokurorja e shtetit i pandehuri , si dhe përfaqësuesi si të dëmtuarës –.

Prokuroja e shtetit pas leximit të aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në dispozitivin e së njëjtës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj dënimin meritator në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri S. N. , pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranojë fajësinë komfor dispozitivit të aktakuzës.

Me që i pandehuri në shqyrtimin e sotëm fillestar ,vullnetarisht e pranojë fajësinë, gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat për pranimin e fajësisë komfor nenit 248, të KPPK-ës, andaj gjykata nuk vazhdoi me administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: duke u bazuar në faktin se i pandehuri S.N. e ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate, lidhur me pasojat dhe përpirësit e pranimit të fajësisë, mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritator sipas ligjit. Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës –me rastin e kryerjes së kësaj veprë penale.

Perfaqësuesi i të dëmtuarës në fjalën përfundimtare deklaroi: në tërësi e mbështes deklaratën e PSH-së ,i bashkëngjitem ndjekjes penale si dhe paraqes kërkesën pasuroro-juridike në vlerë prej €.

I pandehuri S.N. në mbrojtjen e vet ka deklaruar : e pranojë fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem , pendohem për të njëjtën , e njoftoj gjykatën që ka qenë hera e parë dhe e fundit që kam ra ndesh me ligjin, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera të kësaj natyre. Me që jam në gjendje të vështirë ekonomike, jetoj në familje prej 5 anëtarëshe, i pa punësuar , andaj kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Duke u bazuar në aktakuzën përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri si dhe pranimin e fajësisë nga i njëjti, gjykata vërtetoi se te i pandehuri

qëndrojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale , ndryshimi i njësorit të shërbimeve nga neni 323 par. 1 të KPRK-së .

Me rastin e caktimit të dënimit ndaj të pandehurit me kusht ndaj të pandehurit , gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit , sipas nenit 73,74 , 75 dhe 76 të KPRK-ës. Ku si rrethana lehtësuese ka patur parasysh, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të kësaj natyre .

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës –distrikti në Gj...

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimi me kusht, është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit , kështu që gjykata konsideron se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit nga neni 41 i KPRK-ës.

Po ashtu gjykata vlerëson se ky dënim do të ndikoj te i pandehuri dhe personat tjerë, të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nëpar. 2.6 të KPRK-ës .

E dëmtuara konform nenit 463 të KPRK-ës për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 05.12.2016

Sek.juridike,
Rafete Sylja, d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi , mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm në afat prej pesmbëdhjet (15) ditëve, nga data e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kesaj Gjykate Themelore .